



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel.+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

P.SH. Nr. 1091/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) sipas nenit 98, 99, lidhur me nenin 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, në përbërje -Kryetare, Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare Kimete Gashi-Anëtare dhe Vedat Poterqoi -Anëtar, duke vendosur lidhur me kërkesën për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik" e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2, të LPP, ushtruar me datë 15.11.2022 nga NH "Ibër Lepenci" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), ndaj Operatorit Ekonomik (OE) "Jakup Neziri B.I- NT Abetarja" në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material zyrtar" me numër të prokurimit IL- 22-11848-136, me 08.05.2023, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa e datës 15.11.2022, Protokolli 1091/2022, e NH "Ibër Lepenci, e parashtruar në cilësinë e AK, për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga OE, sipas nenit 99 paragrafi 2 të LPP, kurse OE "Jakup Neziri B.I- NT Abetarja" në Gjilan, me numrin unik të regjistrimit 810263880, diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material zyrtar" me numër të prokurimit IL- 22-11848-136, dhe i ndalohet pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik për periudhën kohore 1/ një vit, duke filluar nga data 08.05.2023 deri me datën 08.05.2024.
2. Urdhërohet AK, respektivisht NH "Ibër Lepenci", që ta bëjë konfiskimin e sigurisë së tenderit për OE, me të dhëna si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.
3. Do të revokohet masa e shqiptuar si në paragrafin 1, të dispozitivit të këtij Vendimi, nga dita kur dhe nëse OSHP njoftohet me aktin e organeve kompetente, sipas të cilit vërtetohet se vepra e kualifikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

A r s y e t i m

Me 15.11.2022, NH Ibër Lepenci, në cilësinë e AK, ka dorëzuar në OSHP kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP, ndaj OE "Jakup Neziri B.I- NT Abetarja" me seli në Gjilan, me numër unik të regjistrimit 810263880, nën pohimin se ekziston dyshimi për paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga ky operator ekonomik, sikurse parashihet me nenin 99 par 2 të LPP. Në kërkesën e cituar si më sipër, AK ka shpjeguar se gjatë zbatimit të këtij aktiviteti

të prokurimit, oferta e OE në rastin konkret është cilësuar, oferta me të lirë sipas komisionit vlerësues dhe për këtë arsye i njëjti është rekomanduar të shpërblehet me kontratë.

Prandaj mbi bazën e veprimeve dhe rrjedhës së aktivitetit të prokurimit, AK ka kërkuar që OE (me të dhëna si më sipër) si siguroj dokumentet e përshtatshmërisë, sikurse kërkohen ato në kuptim të LPP (Kreu V. Kërkesat e Përshtatshmërisë dhe të Kualifikimit). Në këtë rast OE, e ka sjellë dy vërtetime tatimore si ne vijim:

1. Vërtetimin tatimor, me numër serik 1000834614 i cili mban datën 26.05.2022.
Mirëpo, me rastin e verifikimit të këtij vërtetimi në ueb-faqe të ATK, data e të njëjtin vërtetim konstatohet se është data 03.11.2021 (d.m.th, jo data sipas vërtetimit të dorëzuar) dhe si rrjedhojë është krijuar dyshuar së ky vërtetim, është i falsifikuar.
2. Vërtetimi tjetër me numër serik 12345890764, nuk gjendet fare në faqen zyrtare të e ATK.

AK ka shpjeguar në vijim se, meqë vërtetimet e cituara si më sipër janë konsideruar të parregullta, i është drejtuar zyrtarisht Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), e cila në përgjigjen e saj drejtuar këtij AK, ka theksuar se vërtetimet tatimore, të cituara si më sipër janë të falsifikuara. Andaj duke u nisur nga këto prova, AK ka kërkuar nga OSHP që konform rregullave ligjore të merren masa ndaj këtij OE, duke i bashkangjitur në cilësi të provës dokumentet si në vijim:

- Certifikata e biznesit të OE “Jakup Neziri B.I. “Abetarja”
- Vërtetimi tatimor me numër serik 1000834614 dhe përgjigjen e ATK-së
- Vërtetimi tatimor me numër serik 1345890764 dhe përgjigjen e ATK-së

OSHP me 14.11.2022 e ka njoftuar OE (me të dhëna si më sipër) lidhur me kërkesën e AK dhe i njëjti me 17.11.2022, ka dërguar përgjigje në të cilën mes tjerash ka shpjeguar se, cituar: “...e-mail i kompanisë sonë është hakuar nga persona dashakeq të cilat si duket kanë pasur skenar dëmtimin e kompanisë sonë duke manipuluar si në këtë rast janë kthyer përgjigje tek autoritetet kontraktuese, në këtë rast N.H Ibër Lepenc i është dorëzuar dokumenti i falsifikuar”. OE ka shpjeguar po ashtu, se AK e ka dërguar kërkesën për dokumente në e-mail dhe pas kontaktimit në telefon kemi njoftuar kemi probleme me e-mail dhe kemi sugjeruar zyrtarin e prokurimit që kërkesën për dokumente të na dërgoj nëpërmjet të e-prokurimit dhe se sipas tij/sajë AK nuk ka vepruar në harmoni me UOPP. Krahas tjerash në përgjigjen e cituar si më sipër, OE ka theksuar se deklaroi me përgjegjësi të plotë morale dhe juridike se nuk kemi bërë këtë veprim, bashkangjitur në këtë shkresë po ju dërgoj pasqyrat financiare të lëshuara nga ATK dhe gjendjen e përgjithshme ku mund të vëreni se kompania jonë nuk ka dhe nuk ka pasur borxhe ndaj ATK as në periudhën kur është kërkuar vërtetimi tatimor, duke kërkuar që refuzohet kërkesën e AK.

Paneli shqyrtues pas analizimit të akteve dhe veprimeve të palëve dhe pretendimeve reciproke të tyre, konstaton se në lënda në rastin konkret përmban dokumente dhe shkresa të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave Paneli ka të drejtë të vendos në aspektin meritator pa prezencën e palëve, sikurse parashihet kjo me nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues pas analizimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde, ka konstatuar se OE në rastin konkret ka dorëzuar në këtë aktivitet të prokurimit dokumente të rreme, përderisa dhe në përgjigjen e tij/sajë e pohon një fakt të tillë duke theksuar se, citat: “...e-maili i kompanisë sonë është

hakuar nga persona dashakeq... ne këtë rast N.H Ibër Lepenc i është dorëzuar dokumenti i falsifikuar". Paneli konsideron se mirëmbajtja e një rrjeti (si pronë private e një biznesi) dhe/ose ndërhyrja eventuale, ilegale dhe e pa autorizuar (hakerimi) në pajisjet e teknologjisë së ndonjë OE, nuk është çështje e cila i takon ndonjë AK dhe si rrjedhojë pa shpjegime tjera në këtë rast, krijon objektivisht bindjen e Panelit për një qasje jo reale dhe me mungesë kujdesi nga OE. Meqë faktet dhe rrethanat e tilla në këtë rast janë jo kontestuese, ato objektivisht krijojnë detyrimin e OSHP që ta aplikoj dispozitën e nenit 99, paragrafi 2, të LPP për zbatimin e së cilës OSHP është kompetent në kuptim të nenit 98, 99, lidhur me nenin 105 të Ligjit të cituar.

Prandaj nisur nga gjykimi profesional dhe bindja e tij e pavarur Paneli konsideron se OE në rastin konkret, duhet të diskualifikohet nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtit ti ndalohet e drejta për të marrë pjesë në aktivitet e prokurimit publik në periudhë kohore prej 1/ një viti, duke filluar nga data 08.05.2023 deri me datën 08.05.2024. Në fakt, nga gjetjet në dosjen e tenderit vërehet se veprimet e OE, në kuptimin se si janë përshkruar ato si më sipër, kanë të bëjnë me *paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik*, sikurse parashihet me nenin 99, paragrafi 2, të LPP dhe për këtë arsye, AK ka paraqitur në OSHP, me 20.10.2022, kërkesë për inicimin e procedurës së diskualifikimit në kuptim të dispozitës së cituar si më sipër.

Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se masa e diskualifikimit, e shqiptuar dhe shpjeguar si më sipër, mund te revokohet nga momenti kur dhe/ose nëse OSHP njoftohet nga autoritetet kompetente se vepra e cituar dhe e komunikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar/e Panelit Shqyrtues



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

- AK Ibër Lepenci
- OE "Jakup Neziri B.I- NT Abetarja"
- Arhivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe;